

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"e-FAS Consulting" Shpk**

- Znj. Valmira Pajenga, datëlindje 27.03.1983 qytetare shqiptare, me vendlindje në Elbasan dhe banim në Lgj. "Luigj Gurakuqi" Rr."Qemal Stafa"; Nd. Pall. 42, H. B, Ap. 3, Rajoni Nr.1, Elbasan.

Kam vendosur të nënshkruaj Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është e-FAS Consulting Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën: Lagja "Luigj Gurakuqi" Rruga "Faik Trungu", Ndertesa Nr.6, Kati 1, Elbasan, Shqipëri. 3001.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka objekt veprimtarie si më poshtë:

- a- Shërbime Kontabël dhe Fiskale
- b- Konsulenca Financiare, Fiskale, Manaxheriale etj.
- c- Ofrimi i shërbimeve të manaxhimit financiar të projekteve dhe fusha të ngjashme të lidhura me to.
- d- Hartim i planeve të biznesit për biznese dhe/ose individë brenda dhe/ose jashtë kufijve të territorit të Republikës së Shqipërisë.
- e- Hartim i planeve të biznesit për projekte turistike dhe agroturizimi, hartimi i planeve të biznesit dhe konsulenca të ndryshme në fushën e agrikultures.
- f- Regjistrim i markave tregtare shqiptare dhe ndërkombetare.
- g- Shitje, blerje, dhenie me qira të pasurive të paluajtshme dhe/ose pasurive të luajtshme.
- h- Shërbime të implementimit të Sistemeve të Menaxhimit Financiar Online dhe Onsite.
- i- Shërbim mirëmbajtje dhe asistencë të sistemeve digitale të Software Financiare.
- j- Shërbim Konsulence për Gjykatën dhe Prokurorinë.
- k- Shërbim Trajnimi dhe Rritje Kapacitetesh për Kontabilitetin Financiar për Biznese dhe OJF.

- l- Shërbime të veprimeve në e-Albania për individë dhe Biznese.
- m- Shërbim konsulence dhe asistencë në Rregjistrimin Fillestar të Bizneseve.

-Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet, shtohet apo kufizohet ne baze të vendimit të Asamblesë se Ortakeve.

Neni 5 - Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100,000 leke** i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.

Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Znj. Valmira Pajenga, datëlindje 27.03.1983 qytetare shqiptare, me vendlindje në Elbasan dhe banim në Lgj. "Luigj Gurakuqi" Rr."Qemal Stafa"; Nd. Pall. 42, H. B, Ap. 3, Rajoni Nr.1, Elbasan të cilës i përket një kuotë me vlerë nominale 100,000 leke, që i korrespondon 100% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 - Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Znj. Valmira Pajenga, datëlindje 27.03.1983 qytetare shqiptare, me vendlindje në Elbasan dhe banim në Lgj. "Luigj Gurakuqi" Rr."Qemal Stafa"; Nd. Pall. 42, H. B, Ap. 3, Rajoni Nr.1, Elbasan të cilës i përket një kuotë me vlerë nominale 100,000 leke, që i korrespondon 100% të kapitalit të shoqërisë e cila emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9- Gjuha


9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

ORTAKËT

Znj. Valmira Pajenga



Datë 01.01.2023